



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo - Territoriale***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 25.3.2026, ora 13:00

**Drejton mbledhjen:**

**Arbjan Mazniku – bashkëkryetar i Komisionit**

**Luçiano Boçi – bashkëkryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i kalendarit të detajuar të takimeve për fazën e parë të konsultimeve në territor.
2. Çështje të tjera.

**Marrin pjesë:**

Arbjan Mazniku, Luçiano Boçi, Romina Kuko, Ermal Elezi, Klevis Jahaj, Xhelal Mziu, Ramadan Likaj, Enno Bozdo, Edmond Haxhinasto, Vangjel Dule, Etleva Budini, Aulona Bylykbashi, Agron Malaj, Vasil Llajo, Igli Cara dhe Artan Luku.

**Mungojnë:**

Ermal Pacaj, Jorida Tabaku, Blendi Klosi, Damian Gjikhuri, Marjana Koçeku dhe Bledjon Nallbati.

## HAPET MBLEDHJA

**Arbjan Mazniku** – Të nderuar miq,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Ju falënderoj për praninë tuaj në këtë mbledhje!

Në vijim të mbledhjes së fundit, ku u dakordësua strukturimi i një agjende, me dakordësi të përbashkët kemi zhvilluar disa takime me bashkëkryetarin dhe kemi punuar bashkërisht për një dokument, të cilin duam t'jua prezantojmë dhe të marrim dakordësinë e të gjithë komisionit. Ky dokument ka dy kolona kryesore. Kolona kryesore janë dëgjesat këtu, në komision, me kryetarët e bashkive, sipas qarqeve. Kemi dakordësuar disa ditë, të cilat të jenë të ndara, që të mos përplasen me ditët kur ka seancë apo me aktivitete të tjera që ka Parlamenti. Kemi menduar që në një ditë të mbulojmë dy qarqe, kryesisht të mërkurave ose...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në një ditë, me kryetarët e bashkive të të dyja qarqeve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në dëgjesë, këtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jemi te kryetarët e bashkive.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, po, në dëgjesë, është kolona e dytë e dokumentit që kemi përpara.

Pra, e fillojmë në mëngjes me kryetarët e bashkive të njërit qark. Dëgjesa mund të zgjasë në një kohë të caktuar. Më pas, në një orë të dytë, thërrasim kryetarët e bashkive të qarkut tjetër. Kjo na jep mundësinë që, në rreth 4 javë, të bëjmë dëgjesat për të gjitha qarqet.

Gjithashtu, kemi dakordësuar që, duke bërë tipikisht dy aktivitete në javë, t'i bëjmë dëgjesat në qark, pra do të shkojmë bashkërisht në këto qarqe, për të bërë aktivitete të mëdha publike. Për këto takime kemi dakordësuar që do të kërkojmë mbështetjen e projekteve prej bashkive të forta, për të na krijuar lehtësi me koordinimin, organizimin dhe të gjithë logjistikën në territor. Kjo na jep mundësinë që këtë fazë të dëgjesave ta përmbylлим deri në fund të muajit prill, duke e kaluar në këtë mënyrë të gjithë territorin e Shqipërisë.

Në dokumentin që keni përpara, që është agjenda, të cilën e kemi ndarë, si bashkëkryetarë komisioni, ndërkohë që kemi caktuar datat, ju kërkojmë të mos i lëvizni ato, pra t'i ruajmë. Nuk i kemi caktuar emrat e qarqeve respektive, në mënyrë që të na jepni mundësinë që, me bashkëkryetarin, të mund të negociojmë rast pas rasti dhe datat e mundshme të jenë më fleksible, kur kryetarët e bashkive të kenë mundësi të jenë aty dhe të kemi një nivel

të caktuar fleksibiliteti, të cilin, sigurisht, do ta konsolidojmë shpejt, por duke negociuar me palët në fjalë.

Po ashtu, kemi një strukturë të ngjashme për pjesën e dytë të dëgjesave, çka na jep mundësinë të fillojmë që nga data 1 maj me dëgjesat tematike, sërish këtu, në Parlament. Kështu, ruajmë kolonën e dëgjesave në komision, ku kemi dëgjesat sipas fushave specifike të kompetencave dhe temave specifike që duhet të diskutojmë. Kjo agjendë na krijon një strukturë të qartë të realizimit të të dy objektivave, edhe dëgjesa fillimisht me kryetarët e bashkive, pastaj me ekspertët e fushave respektive apo me institucionet përgjegjëse këtu, në komision, si dhe mundësinë e takimeve në territor.

Nëse jemi dakord me këtë agjendë, do të kërkoja të dëgjonim komentet dhe më pas ta miratojmë.

**Luçiano Boçi** – Faleminderit!

Së pari, dua të përshëndes ekspertët e pranishëm! Është një moment shumë i rëndësishëm dhe ne gjykojmë se kjo reformë nuk duhet të jetë thjesht një vendimmarrje politike, por edhe një vendimmarrje që mbështetet në punën bazike të ekspertëve. Tekefundit, reforma prek drejtpërdrejt organizimin e shtetit në territor, përfaqësimin qytetar (si përfaqësohet qytetari, si i shërbehet) dhe, sigurisht, demokracinë vendore. Në këtë pikë, roli i ekspertëve, për mendimin tonë, është shumë i rëndësishëm, ndaj edhe ne kërkojmë dhe presim nga ata një ekspertizë serioze, të strukturuar mirë dhe të pavarur. Është shumë rëndësishme që ky vendim politik të mos jetë thjesht politik, që afekton administrimin e pushtetit vendor, por të jetë një proces i hapur, që u referohet problematikave që ka realiteti i pushtetit vendor në Shqipëri.

Të dashur ekspertë, ne presim një ekspertizë shumë serioze, të detajuar nga ju, pasi jeni ju ata që do të bëni ballafaqimet, do të nxirrni në pah situatën reale të pasojave të reformës së periudhës 2014-2015, do t'u referoheni përvojave më të mira me argumente bindëse dhe do t'i sillni para komisionit. Në këtë pikë, puna juaj është shumë thelbësore. Për më tepër, mendoj se funksioni juaj ka edhe një dimension tjetër, që lidhet me besueshmërinë e publikut. Publiku e mirëpret reformën territoriale, ka shumë interes, por, njëherazi, ai nuk mendon se kjo reformë do të jetë produkt i zyrave të mbyllura, i marrëveshjeve politike, por produkt i transparencës, i punës profesionale, i argumenteve dhe fakteve që sillen nga ju, patjetër, në mënyrë më të mirë, më të thelluar, me qëllim që kjo reformë territoriale të mos jetë vetëm vendim politik (sigurisht që është vendim politik), por të jetë edhe një reformë që ka brenda dijen, informacionin, profesionalizmin dhe ndërgjegjen tuaj.

Shumë faleminderit që keni pranuar të jeni pjesë e këtij procesi që lidhet me një përgjegjësi dhe kërkon seriozitet shumë të madh! Ju uroj suksese, në emër edhe të komisionit, pra jo vetëm në emër të Partisë Demokratike!

Sigurisht, ne presim shumë nga ju dhe jemi të bindur se puna juaj do të jetë shumë orientuese për konkludimet tona.

Besoj se duhet sqaruar që ekspertët janë pjesë e agjendës, do të marrin pjesë, por nuk duhet ta reflektojnë ndarjen *quasi* politike, sepse një pjesë e tyre janë zgjedhur nga vullneti politik i mazhorancës, një pjesë nga vullneti politik i opozitës. Puna e tyre duhet të ecë sikurse e parcelizuar, por sidomos *on groupe*, mendoj unë, dhe këto informacione nuk duhet të afektohen nga qëndrime politike për situatën që kemi përpara, për ballafaqimet apo për ato dëgjesa që ne do t'i realizojmë së bashku. Pjesë e miratimit të kësaj agjende jeni edhe ju dhe, ndoshta me *visto*-n tonë, mund të jepni mendimin tuaj, por, duke qenë se kemi një dakordësi paraprake, si drejtues të këtij komisioni, mendojmë se debatet ndoshta nuk do të jenë aq të zjarrta në këtë mbledhje sa kanë qenë më përpara, por mund të modifikojmë ato lëvizje që janë përshtatshme në raport me grupet që kemi ngritur për të ndjekur qarqet sipas territorit dhe që duhet të azhurnohen edhe sipas agjendave që kanë deputetët e komisionit dhe ekspertët.

Ju uroj suksese, sigurisht, duke i uruar suksese edhe punës së komisionit në këtë fillim dëgjësash të kërkuara, të domosdoshme dhe që vërtet kanë filluar të japin impaktet e tyre të para!

Ne kemi bërë një dëgjese me komunitetin e Hasit dhe kërkesa e tyre ka qenë taksative. Hasi duhet të qëndrojë bashki, siç edhe u parashtruan shumë argumente, madje edhe nga specialistët. Mendoj se puna fillon vërtet tani dhe dëgjesat, në bashkëpunim me ekspertët, që do t'i konsiderojnë ato, do të nxjerrin në pah punën tonë efektive dhe do të kemi një konkludim që synon të jetë konsensual (e theksoj, gjithmonë konsensual), një vendim i përbashkët.

Faleminderit!

**Arbjan Mazniku** – Shumë faleminderit!

Në fakt, unë doja ta diskutoja çështjen e ekspertëve në një fazë të dytë, por meqenëse bashkëkryetari e nisi, edhe unë dua t'u uroj ekspertëve fillim të mbarë pune!

Meqenëse u kalua numri i ekspertëve dhe emrat e tyre në Byronë e Kuvendit javën e shkuar, tani mund ta fillojmë punën formalisht edhe nga ana teknike. Nga të dyja palët kemi një propozim dhe jam shumë i lumtur që kemi njerëz me eksperiencë dhe me profesionalizëm. Besoj se ky grup përbën siguri dhe garanci për një kolonë profesionale, veç asaj politike, një kolonë teknike ekspertësh, që do të ofrojnë vlerësimin më të mirë të mundshëm teknik për

punën. Por na pret shumë punë përpara, kështu që do të jemi në mënyrë sistematike bashkë për të ecur përpara.

Mendoj të kthehemi te çështja e agjendës, në mënyrë që të ecim përpara.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Luçiano Boçi** – Atëherë, zoti Elezi, fjala për ju.

**Ermal Elezi** – Unë kam vetëm një koment teknik. Në kalendar, te pjesa e dëgjesave të mëdha, mungon një qark. Në vend të jenë 12, janë vetëm 11 dhe, përkatësisht, sipas ngjyrave, mendoj se mungon te Jugu. Kështu që, duhet shtuar dhe korrigjuar në agjendë.

Kaq kisha.

**Arbjan Mazniku** – Zoti Elezi, nuk mungon një qark. Qarku i 12-të është shënuar me emër; në fund.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Ermal Elezi** – ...problem me ngjyrat, se ka vetëm tri qarqe të Jugut.

**Arbjan Mazniku** – Po, me ngjyrat mund të ketë probleme.

**Enno Bozdo** – Unë kam disa ndërhyrje, por janë më shumë pyetje se sugjerime.

Së pari, mendoj se Tirana, për vetë rëndësinë që ka, duhet të marrë më shumë sesa një ditë, dhe kjo për shumë arsye. Se në ç'mënyrë mund ta trajtojmë, besoj se e gjeni menjëherë gjuhën e përbashkët, por Tirana, për specifikën që ka, duhet të marrë pak më shumë kohë, ndoshta 2 apo 3 ditë, për të trajtuar disa tema të caktuara. Nuk e di, mund ta vendoseni ju të dy, dhe për mua është në rregull.

Së dyti, në javën e gjashtë dhe të shtatë janë parashikuar takime me dëgjesa tematike. Besoj se këtu përfshihen edhe grupet e interesit, apo jo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo?

**Arbjan Mazniku** – Jo në këtë fazë. Pra, në këtë fazë, dëgjesat tematike janë presupozuar të ishin, siç kemi folur edhe në dokumentin e parë, sipas fushave kryesore të funksioneve të bashkisë...

**Enno Bozdo** – E kuptova.

**Arbjan Mazniku** – Pra, grupi që merret me strehimin, grupi që merret me financat, grupi që merret me infrastrukturën, me shërbimet...

**Enno Bozdo** – E qartë.

Tani, normalisht, lind pyetja: kur do t'i bëjmë dëgjesat me grupet e interesit? A do t'i bëjmë (dhe besoj se duhet t'i bëjmë)? Kur? Kam përshtypjen se duhen parashikuar edhe këto në kalendar.

**Arbjan Mazniku** – Në dokumentin origjinal, që kemi miratuar para dy mbledhjesh, kemi disa *slot*-e të mëdha kohe. Ato janë parashikuar në *slot*-in e tretë të kohës. *Slot*-i i parë është presupozuar dëgjesa me kryetarët e bashkive dhe komunitetet atje, *slot*-i i dytë është me grupet, me funksionet, dhe më pas kemi diskutimin, të themi, me komunitetet, me grupe interesi specifike apo me... Logjika është që ta fillojmë me diskutimin me këto grupe. Kur të kemi filluar, të kemi konsoliduar disa ide të caktuara, që edhe ata t'i pyesim për disa gjëra që janë të prekshme.

**Enno Bozdo** – Kjo po, por meqenëse këtu kemi të bëjmë...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Mendimi im është që, meqenëse kemi të bëjmë me një kalendar shumë fleksibël, këtij kalendari mund t'i shtohet edhe një fazë e tretë këtu, duke i lënë, jo temat dhe grupet e interesit, por siç është bërë, pra takime me grupe interesi, një, dy, tri, katër apo një, dy, tri, apo një, dy, tri, shtatë, nuk ka rëndësi kjo, thjesht për ta bërë më të plotë, që të jetë më e kuptueshme për të gjithë. Pastaj, nëse ju të dy gjykoni se kjo mund të ndodhë pas 10-15 ditësh, prapë është në rregull. Mjafton të dimë se do të kemi edhe grupe interesi.

**Arbjan Mazniku** – Patjetër që po dhe do të ndodhë.

**Enno Bozdo** – Dakord.

Kam edhe një pyetje të fundit, meqenëse kemi edhe ekspertët: çfarë është bërë me çështjen e ekspertëve ndërkombëtarë, nga i presim dhe kur mund të kemi një kontakt edhe me ta?

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

**Luçiano Boçi** – Kam një ndërrhyrje të vogël në raport me kërkesën që bëri Enno për grupet e interesit. Në fakt, po, e vërtetë është, te *slot*-et e kishim të paraqitur një agjendë të tillë.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Jo, mund të shtohet edhe në dëgjesat e qarqeve, por varësisht nga koha që kemi në dispozicion. Pra, mund ta shtojmë dhe ta bëjmë të njëkohshme, ku, sipas qarqeve, të bëjmë takim të hapur dhe takim me grupet e interesit. Këtë e gjykojmë ne ose e vendosim në vazhdimësi, por edhe sa i përket idesë që këto takime t'i vendosim pasi të kemi realizuar dëgjesa paksa bruto, pastaj të kalojmë te grupet e interesit dhe pak profesionale, se kemi edhe tematiket, mund t'i bëjmë edhe pas këtyre.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Jo, ta pasqyrojmë dhe ta kemi si opsion.

Lidhur me ekspertët ndërkombëtarë, unë sapo kam firmosur një shkresë të ardhur nga ambasadori Gonzato, ku shprehet gatishmëria e mbështetjes edhe për ekspertët, edhe për

vizitat, edhe për agjendën e komisionit, sikurse është pranuar kërkesa jonë, si bashkëdrejtues, nga ambasada zvicerane, për të ofruar suportin e saj në të gjitha drejtimet dhe në të gjitha kërkesat që komisioni ynë do të ketë, duke përfshirë këtu edhe ekspertët ndërkombëtarë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, kjo gjë është konfirmuar edhe në takimet përkatëse që kemi zhvilluar me ambasadorët. Kështu, në një moment shumë të afërt do t'i kemi edhe ekspertët ndërkombëtarë.

Faleminderit!

Fjala për ju, zoti Jahaj.

**Klevis Jahaj** – Jo, e kam më shumë për sqarim, por besoj se do t'i kemi.

Në takimet për dëgjesat e mëdha, unë mund të isha i mendimit që, duke qenë se jemi në një qark, të mund të jenë dy takime dhe të mos jenë të përziera ndërmjet grupeve të interesit dhe njerëzve apo personave të tjerë që kanë interes, por nuk kanë drejtpërdrejt kërkesa specifike në lidhje me këtë gjë. Pra, në një takim në qark mund të bëhen në dy brenda ditës, duke qenë se do të jemi aty. Mund të ketë edhe me grupe interesi ose edhe me komunitete të caktuara që lidhen me këtë. Vlen të diskutohet. Nuk e di si është menduar, prandaj e pata më shumë si pyetje. Por në qoftë se këto do të jenë të përqendruara më vonë, në një moment tjetër, sipas asaj që kemi lënë, edhe kjo është e pranueshme për ne, sepse mund të kemi edhe për produkte ose tema specifike që mund të kenë dalë edhe nga diskutimet me kryetarët e bashkive ose me komunitetet e ndryshme në qark.

Shumë faleminderit!

**Luçiano Boçi** – Edhe unë, pak a shumë, këtë mendim kisha, por, duke e përpunuar, frika ime është që seancat dëgjimore ose dëgjesat në qarqe kanë kohë paksa të gjatë, meqenëse nuk kemi përcaktuar një periudhë kohore kur mund t'i bëjmë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dhe të mos e lëmë, kështu, në varësi të mbarimit të një dëgjese, pra të mos vendosim gong që këtu mbaron gjithçka, se duket sikur është formale.

Edhe për nga logjika që u parashtrua këtu, më duket më e përshtatshme që t'i realizojmë më pas. Mund t'i realizojmë edhe këtu, sepse grupet e interesit janë të interesuara të vijnë pranë komisionit, dhe jo vetëm, por të jenë të interesuar të vijnë dhe të bëjmë një debat të shëndoshë këtu.

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Arbjan Mazniku** – Po, zoti Mziu.

**Xhelal Mziu** – Përshëndetje!

Mbaj mend se, para një muaji ose më shumë, pati një ankesë nga të dyja kahet se ritmi i punës ishte shumë i avashtë dhe shpresuam që periudha në vazhdim do të ishte intensive, duke shfrytëzuar ndoshta edhe 5-6 ditë në javë. Por nga ajo ditë, vetëm një ditë tjetër jemi mbledhur dhe sot është dita e dytë. Me këtë ritëm, jo në korrikun e këtij viti, por as në korrikun e vitit tjetër nuk arrijmë të krijojmë një substancë dhe një produkt siç duhet.

Së dyti, ne hartojmë një program, ku thuhet se do të takojmë 12 kryetarët e qendër-qarqeve, pra në takimet që do të bëjmë ose dëgjesat. Në praktikën time, jo vetëm te Komisioni i Reformës Territoriale, po themi, i mbajtur dy herët e kaluara, por edhe në komisionet e tjera të posaçme që bëhen, komisioni ka nevojë për t'u ushqyer me informacion dhe, për të marrë përgjigje të një shkresë, duhet minimalisht gati një muaj, për të mos thënë pastaj që, kur nuk e sjellin informacionin e duhur, do t'i drejtohesh për së dyti për ta marrë.

Pra, që ne të bëhemi efektivë, është absurde që ju, si bashkëkryetarë, të mos u drejtoheni strukturave për të marrë informacionet e nevojshme. Bie fjala, ka aktorë të rëndësishëm, si: Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Pushtetit Vendor, nëse ekziston, pavarësisht se është pa portofol, Statistikat, Thesari apo 61 bashkitë, për t'u dërguar shkresë dhe për të marrë informacionet e nevojshme, qoftë edhe për të parë cili ka qenë standardi deri para reformës së vitit 2014, pra edhe për të marrë vesh cila ka qenë ecuria e saj nga viti 2014 deri në vitin 2025. Pra, në këndvështrimin tim, duhen përpiluar urgjentisht shkresat drejtuar këtyre institucioneve, për të sjellë informacionin e duhur.

Së treti, sa herë jemi mbledhur, kemi kërkuar... Sepse ne po presim të futemi në Bashkimin European në vitin 2027, siç ka thënë edhe qeveria, por ndoshta edhe në vitin 2030 apo kurdo qoftë ajo, ne duhet të shkojmë drejt standardeve të Bashkimit European.

Ne bëjmë një reformë dhe ju jeni të bindur se ka dështuar. Ne duhet të aplikojmë një praktikë të vendeve të Bashkimit European. Kemi kërkuar, por akoma nuk është planifikuar, për të shkuar në dy nga vendet e Bashkimit European, për të parë cilat janë kompetencat, cila është pavarësia, cili është decentralizimi, cili është standardi që kanë këto vende të Bashkimit European. Kështu që, është momenti për t'i dhënë zgjidhje, për të pasur një model suksesi të paktën dy nga vendet e Bashkimit European. Ne duhet t'u drejtohem me shkresë po përsëri 61 bashkive, por edhe institucioneve qendrore, për të parë disa nga treguesit që japin informacion koherent. Bie fjala, sa ka qenë numri i punonjësve në vitin 2015 në 373 njësitë vendore dhe sa është sot ai numër? Sa ka qenë përqindja e investimeve në atë vit dhe sa është përqindja e investimeve sot? Sa para shkonin për paga dhe sigurime shoqërore atëherë dhe sa shkojnë sot? Sa social është buxheti i këtyre bashkive, pra sa para shkonin për shpenzime operative apo

shpenzime të tjera sociale në drejtim të qytetarëve në atë periudhë dhe sa shkojnë sot? Për t'i bërë këto pyetje, duhet t'i paraprijmë me shkresa.

Po ashtu, besoj se duhet të bëjmë një grafik për t'i dëgjuar këto 61 bashki, për të dëgjuar institucionet qendrore, të cilat kanë lidhje me pushtetin vendor. Ndërkohë, duhet të merremi edhe me dy probleme të tjera shumë të rëndësishme. I pari është disproporcionaliteti i ndarjes territoriale. Të paktën nga komunikimet që ne bëjmë duke dalë në zonë, kemi dy flukse grupimesh që kërkojnë takim apo dëgjësë. Së pari, duke u udhëhequr edhe nga propaganda që bën Partia Socialiste për reduktimin e këtyre bashkive, kemi disa bashki, të cilat kërkojnë me ngulm për të mos u bashkuar me një bashki tjetër. Më themelorja, që unë besoj se është edhe kryefjala e kësaj reforme territoriale, është rritja e numrit të bashkive në intervalin që ka mbi 10 vjet që kërkohet dhe që i përafrohet edhe standardeve të Bashkimit Europian, ndonëse ngelim po prapë shumë larg raportit qytetar për njësi vendore, sepse ne e kemi centralizuar atje ku s'mban më.

Kështu që, ne duhet të planifikojmë patjetër takime me qytetarët dhe dy janë flukset kryesore. Kemi zona si Fushë-Kruja, Shëngjini, Velipoja, Rubiku, Miloti, Maqellara, Kastrioti apo të tjera, të cilat kërkojnë për t'u kthyer në bashki më vete, ashtu siç ka dhe bashki të tjera që nuk kërkojnë për t'u bashkuar me dikë tjetër. Kështu që, unë përmenda një sërë problemesh të cilat duhen prekur, duhen marrë në konsideratë, por finishi i kësaj platforme për të pasur vërtet një pushtet vendor konform standardeve është i pamundur për t'u kapur në kohë, që të implementohet për zgjedhjet e vitit 2027.

Faleminderit!

**Arbjan Mazniku** – Faleminderit!

I vetmi koment që kam është se jam shumë i kënaqur që jemi në fazën e nxitjes për të bërë punë. Besoj se do të nisim, sipas kërkesës së zotit Boçi, ditën e premtë, datë 3 prill, me një diskutim paraprak me ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor. Tani që kemi formalisht dhe ekspertët, një pjesë e kërkesave që u ngritën janë pjesë e agjendës së punës së ekspertëve për të mbledhur dokumentet dhe për të bërë një raport. Ndërkohë, duke nisur nga java që fillon me 6 prill, do të kemi praktikisht katër evente në javë. Pra, do të kemi takime me dy qarqe dhe do të kemi dy aktivitete në javë. Kështu që, në atë moment besoj se do të intensifikohet më shumë edhe procesi. Arsyeja pse kemi marrë kohë është se kemi pasur diskutime për mënyrën se si duhet bërë agjenda. Ne kemi propozuar një seri agjendash dhe më në fund kemi një për të cilën shpresojmë të biem dakord, ta mbyllim e ta fillojmë ta zbatojmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Luçiano Boçi** - Një minutë, Xhelal, se prandaj e mora fjalën.

Atëherë, parashtruat një kërkesë për vizitë në dy vende, që e kemi trajtuar edhe më parë. Vendet do t'i vendosim ne me vendimmarrje se ku, sipas modeleve, ndoshta na ndihmojnë dhe ekspertët, që unë e parathashë në fjalën time. U takon atyre ndoshta që të na bëjnë një orientim më profesional, por mund t'i zgjedhim edhe vetë nga njohuritë që kemi. Kam këtu shkresën e Delegacionit të Bashkimit European, i cili në pikën 7 e përcakton se është i gatshëm të na mbështesë me organizimin e një vizite studimore në dy vende europiane, sipas kriterëve orientuese. Pra, këto vizita në këto dy vende do të realizohen nga komisioni, pastaj kohën e tyre do ta vendosim ne.

Në raport me kërkesat për informacion, ka qenë pjesë e diskutimeve që kemi bërë me ekspertët. Ekspertët e duan këtë informacion, madje kanë përgatitur edhe shkresat përkatëse, të paktën ekspertët tanë, të cilat do të firmosen nga dy bashkëkryetarët dhe do t'u drejtohen institucioneve, që të mos kenë asnjë lloj kufizimi për marrjen e të gjitha informacioneve që atyre u duken të domosdoshme për qeverisjen, për kompetencat, për anën financiare apo për territorin. Të gjitha këto do të jenë pjesë e kërkesave të ekspertëve.

Për sa u përket dëgjesave, faktikisht këtu duhet të japim një përgjigje dhe ndoshta duhet të parashikojmë dëgjesa sipas kërkesave me komunitete të caktuara, gjë që nuk e kemi parashikuar. Duhet të lëmë vende bosh, duhet të kemi një spostim, se në qoftë se vazhdojmë vetëm me këto, por puna është e ngarkuar, katër ditë në javë janë goxha ditë pune dhe janë edhe me orare goxha të zgjatura, do të na duhet të ndërpusim herë pas here dëgjesat që na vijnë nga komunitetet, që janë disa ...

Sekretari i komisionit më ka listuar një sërë kërkesash, që unë i kam këtu, të cilat duhet të vihen në dijeni, por që mund të shtohen në ditët në vazhdim. Pra, t'i bëjmë të rakorduara, sepse marrim njëkohësisht disa opinione dhe disa mendime. Këtu do të na duhet një ndërhyrje, sepse këto do t'i bëjmë pasi të mbarojmë këto apo do t'i bëjmë pasi të dëgjojmë dhe tematikat. Mund të ketë propozime të ndryshme, por unë mendoj që t'i bëjmë të rakorduara ose edhe duke i grupuar në blloqe, siç kemi vepruar për këto dëgjesa. Pra, pa i shmangur, janë krejtësisht të domosdoshme dhe metodologjia për t'i lënë në fund ndoshta është edhe funksionale, se s'dimë numrin e tyre. Ndërkohë, marrim kërkesat dhe në fund ne bëjmë të gjitha dëgjesat që ata na dërgojnë. Këto dy alternativa kemi, por në asnjë moment nuk është shmangur pranishmëria e këtyre dëgjesave nga komunitete të caktuara.

Faleminderit!

**Arbjan Mazniku** - Jam plotësisht dakord me zotin Boçi që këto dëgjesa duhet t'i bëjmë në bllokun e tretë. T'i mbledhim të gjitha kërkesat nga të gjithë njerëzit dhe sigurisht të bëjmë të gjitha dëgjesat që duhet të bëjmë, qofshin këtu, qofshin me nëngrupe, qofshin edhe me idenë

që disa nga ne të shkojnë ta bëjnë dëgjuesin te komuniteti respektiv, por për sa kohë që ne jemi duke diskutuar për kompetencat, për funksionet, për çfarë ka funksionuar apo s'ka funksionuar, besoj se nuk është ende momenti që ne të bëjmë diskutime për Hasin apo Maqellarën, nëse do të jenë bashki apo s'do të jenë bashki, se nuk është ende diskutimi që po bëjmë. Diskutimi që po bëjmë në këtë fazë ka të bëjë me kompetencat, me funksionet, me mundësinë e tyre për ta ushtruar siç duhet funksionin. Të ezaurojmë këtë fazë diskutimi dhe kur të merremi në mënyrë më sistematike me territorin dhe me funksionet, pa dyshim në atë moment duhen bërë dëgjesa me secilin prej këtyre komuniteteve, se është fazë shumë e rëndësishme që duhet të ndodhë, jo thjesht me grupet që kanë shprehur tashmë interes, por me të gjitha grupet në territor. Kështu që, jam dakord me këtë qasje.

**Aulona Bylykbashi** - Në fakt, unë kisha vetëm një propozim në raport me këtë që sapo diskutuam, me dëgjesat që do të bëhen në varësi të kërkesave të bëra nga aktorë të ndryshëm. Ndoshta duhet të përcaktojmë një datë përfundimtare si *deadline* brenda së cilës këta aktorë mund të dorëzojnë këto kërkesa, sepse mund të na ndodhë që në një fazë të tretë, kur ne të kemi përcaktuar takimet për dëgjesat përkatëse, të depozitohen pas saj kërkesa të tjera, të cilat do të na e shtyjnë sërish procesin. Për sa kohë që koha është e mjaftueshme dhe informacioni është publik, ne mund të përcaktojmë bashkërisht një datë që mund të jetë e arsyeshme si *deadline*, brenda së cilës të gjithë personat e interesuar mund të depozitojnë kërkesat e tyre.

Faleminderit!

**Luçiano Boçi** – Faleminderit!

Unë mendoj që tani nuk e kemi urgjente përcaktimin e *deadline*-it për një arsye të vetme, që nuk kemi kontakt informativ mjaftueshëm me publikun, nuk është ndërtuar ende faqja *web* e komisionit, dhe kjo na pengon në komunikimet që realizohen sot. Sigurisht, është pjesë e rëndësishme e fushatave informative dhe hapja e dëgjësive në një formë të tillë në bazë qarqesh, në bazë tematikash dhe në bazë të grupeve të interesit, do të krijojë një lloj reagimi dhe ne duhet të presim kërkesat e tyre. Nuk mund të refuzojmë. Është shumë e vështirë që ky komision të vendosë kufij kohorë për të refuzuar kërkesa që vijnë nga komunitetet. Është punë shumë e lodhshme, e dimë shumë mirë, e kemi marrë përsipër, dhe ne do të ecim edhe duke respektuar afatet kohore, por duke përmbushur edhe kërkesat e komuniteteve, sepse, dashur pa dashur, do të na krijohen reagime për diskriminim, dikush është dëgjuar, dikush nuk është dëgjuar. Ndaj, mendoj ta shohim në vazhdimësi. Në qoftë se do të ketë nevojë për një *deadline*, kur informacioni të jetë i plotë dhe publiku të jetë i informuar, atëherë ne marrim një vendim të tillë, e vendosim, por tani është ende herët mendoj unë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Dakord, në kohën e duhur. E bashkova edhe propozimin tuaj, edhe momentin kohor.

Faleminderit!

**Arbjan Mazniku** – Përgjigja tjetër, që besoj se vlen edhe për publikun, është se tani që grupi i ekspertëve është aktiv, një pjesë e grupit të ekspertëve, në bashkëpunim, do të punojmë për kontentin dhe përbërjen e faqes së posaçme, se pjesë e çështjes është që ne kemi kërkuar që faqja të ishte, por duhej që njerëzit të ulëshin, të shkruanin kontentin, strukturën, tipologjinë, dhe pastaj do të ndërveprojnë me ekspertët teknikë për ta hartuar. Besoj se për punë ditësh faqja do të jetë aktive tani që ekspertët janë funksionalë.

Zoti Bozdo.

**Enno Bozdo** - Një ndërhyrje shumë shkurt kam, pa dashur të vonoj. Do t'u kërkoja të dy bashkëkryetarëve që në pjesën e njerëzve, të individëve, funksionarëve që do të ftoni, veçanërisht kur kemi dëgjesa me bashkitë e qarkut, të shihet mundësia që të ftohen nga të dy krahët edhe administratorët e njësive administrative, sepse jo vetëm pasurohet, por mendoj se na jep edhe një kolor më të mirë. Një gjë është bashkia në qendër, një gjë tjetër është...

Të mos harrojmë se këto kanë qenë të gjitha komuna dhe kanë disa problematika të tjera që qendra nuk i has ose...

Kështu që, kur të vijë çasti, mendoj se kjo duhet pasuruar edhe me ftesa për këto pozicione.

**Luçiano Boçi** - Për ta avancuar pak më shumë idenë e Ennos, sigurisht që është e domosdoshme të thirren drejtuesit e njësive administrative, por meqenëse ne kemi një realitet jo të balancuar politik për shkak të zgjedhjeve, në dëgjesat me bashkitë, që në shumicën e tyre janë majtas, administratorët janë majtas, ne të thërrasim, për të balancuar dëgjesat, ish-administratorë të Partisë Demokratike, në një numër të caktuar dhe duke prekur të gjitha njësitë administrative, por duke i koordinuar dëgjesat që do të realizohen brenda në komision. Duket masë shumë efektive për mbarëvajtjen e punës së komisionit.

Faleminderit!

**Arbjan Mazniku** - Tani, kur bëmë agjendën e parë, atë që propozuam mbledhjen e shkuar, ishte ekzaktësisht kjo arsyeja pse ne kërkuam që t'i bënim dëgjesat atje. Për shembull, në qarkun e Elbasanit ka shtatë kryetarë bashkish dhe 39 njësi administrative. Nëse tani do të thërrasim në një seancë dëgjimore këtu shtatë kryetarë bashkish dhe nga dy njësi administrative për çdo bashki, u bënë 14 të tjerë dhe sapo shkuan 30 veta të ftuar, të cilët në fund nuk i pyesim dot dhe as i dëgjojmë dot. Ne menduam të shkojmë atje, sepse është më kollaj ta bëjmë këtë bisedë atje. Zgjidhja që gjetëm dhe që u dakordësua, që të mos rihapim prapë diskutimet, është që të thërrasim kryetarët e bashkive në këtë proces. Në qoftë se në një moment të caktuar duam

të bëjmë një ushtrim dhe zgjedhim të thërrasim një grup të selektuar administratorësh për një dëgjese të posaçme vetëm me disa administratorë, unë jam shumë i hapur që ta fusim te dëgjesat tematike në një moment të caktuar. Arsyeja pse kërkova, gjithashtu, në diskutimet e mëparshme, përveç takimit me administratorët, duke shkuar në qarqe, të kishim bërë atje edhe takime me stafet e fushave respektive, atë që mbulon financën, që mbulon urbanistikën, që mbulon çështjet ligjore, ato që mbulojnë shërbimet sociale, ishte pikërisht që të shtonim një kolor tjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Këtu ngeli, këtu u dogj agjenda javën që kaloi.

**Enno Bozdo** - Jo, s'ka ngelur për këtë.

**Arbjan Mazniku** - ... se do të ngecin prapë.

**Enno Bozdo** - Jo nuk desha t'i rikthehem, por kryetari sapo iu rikthye dhe ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Patjetër, por dua të them këtë gjë: kjo nuk na pengon që ndërsa shkojmë në qarqe, t'i konsiderojmë administratorët dhe ish-administratorët grup interesi. Mund të bëjmë edhe atë që thotë zoti Jahaj, edhe një takim tjetër, por edhe ndërsa i thërrasim këtu, sigurisht duke mos pretenduar që të ketë përfaqësi 100%, po 3-4 ne mund t'i thërrasim dhe e bëjmë edhe më të pasur dëgjesën tonë.

**Arbjan Mazniku** - Zgjidhjen e kishim në tavolinë javën që kaloi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Luçiano Boçi** – Atëherë, do të votosh atë që ke pranuar apo ....

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Besoj se po. E paske me nxitim sot.

**Arbjan Mazniku** - Ka diskutime apo sugjerime të tjera praktike? Po, zoti Llajo.

**Vasil Llajo** – Faleminderit!

Do të ishte mirë të merrej në konsideratë veçantia dhe specifiteti që kanë bashkitë e minoriteteve, me qëllim që ato të dalin si një kolorit i një pune studimore me ato veçori që kanë. Ndoshta duhet të ndajmë një ditë të veçantë vetëm për të bërë dëgjesat me bashkitë e minoriteteve.

Faleminderit!

**Arbjan Mazniku** – Faleminderit!

Mund ta shohim si opsion. Po, zoti Haxhinasto.

**Edmond Haxhinasto** - Unë jam dakord me agjendën, por, siç e thashë edhe në mbledhjen e kaluar, për hir të eficiencës duhet të strukturojmë pak diskutimin që do të bëjmë

për dëgjesat, sepse këto takime janë relativisht me numër të konsiderueshëm dhe potencialisht diskutimi mund të jetë i shumëllojshëm. Do të sugjeroja që të bëhet një marrëveshje nga dy bashkëkryetarët për sa u takon tematikave, se s'mund të jenë edhe për çështje që dalin jashtë kuadrit të qëllimit të këtij komisioni (dhe njerëzit kanë tendencë që të flasin për këto). Kështu që, unë sugjeroj që ju të dy të bini dakord për tematikën për të cilën duhet të përgatiten në mënyrë të përgjithshme ata që do vijjnë për dëgjesë këtu. Kjo do të vendosë disa korniza që do të orientojnë diskutimin dhe do të rrisin eficiencën e punës. Në gjykimin tim, duhet të jetë patjetër një vendim i përbashkët.

**Arbjan Mazniku** - Jam shumë dakord me propozimin tuaj. Besoj se do të ishte shumë e udhës që, përveç temave (kemi kohën e mjaftueshme që të biem dakord), kur t'u çojmë ftesën kryetarëve të bashkive për të qenë prezentë në këto dëgjesa, të biem dakord për një protokoll modaliteti të mënyrës së dëgjesës, që të ketë brenda kohëzgjatjen e dëgjesës, kohën që do t'i japim secilit për t'u përgjigjur, kohën e pyetjeve, që të kemi një modalitet që të na lehtësojë punën dhe të ketë produkt të prekshëm. Kështu që, jam dakord me propozimin tuaj.

**Luçiano Boçi** – Për këtë metodologji ne kemi kërkuar asistencën e “Bashkive të Forta” edhe në dokumentin që kemi firmosur. Kështu që, e presim. Kemi prezentë zonjën Karakaçi, e cila është në dijeni të kësaj. Kështu që, mirëpresim një metodologji për të gjitha këto që u kërkuan nga anëtarët e komisionit në një kohë sa më të shpejtë të mundshme.

Faleminderit!

**Arbjan Mazniku** - Nëse nuk kemi diskutime të tjera, atëherë e miratojmë agjendën që kemi përpara, për ta kthyer në një dokument formal, në mënyrë që më pas, bashkë me grupin e ekspertëve, të fillojmë të parashikojmë datat dhe të kontaktojmë institucionet përkatëse për t'i filluar dëgjesat siç i kemi të parashikuara. Jemi dakord? Duke qenë se të gjithë janë dakord, besoj se me këtë çështje rendi i ditës mbyllet.

Ju falënderoj dhe shihemi në mbledhjen e radhës!

**Luçiano Boçi** – Faleminderit!

**MBYLLET MBLEDHJA**